



Prof. Dr. Elvin Meka
Dekan
Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë
Tirana Business University College

Prof. Dr. Elvin Meka është diplomuar në Bachelor në Financë-Kontabilitet, Universiteti i Tiranës; Master in Business Administration, University of Nebraska–Lincoln & Universiteti i Tiranës, SHPU në Administrim – Biznes, Universiteti i Tiranës, Doktor i Shkencave në Ekonomi, Universiteti i Tiranës.

Prof. Meka ka një përvojë mbi 13 vjeçare në mësimdhënie në nivel universitar, me eksperiencë profesionale mbi 16 vjeçare në sistemin financiar shqiptar, pranë institucioneve të ndryshme qendrore dhe private (banka dhe jo-banka), në çështje që lidhen me tregjet e letrave me vlerë dhe instrumentet financiare, dërgesat e emigrantëve, sistemet e pagesave, bankingun qendror dhe tregtar, etj. Ka publikuar shumë artikuj shkencorë në revista të njohura shkencore, brenda dhe jashtë vendit. Ai ka qenë Zv.Dekan & Përgjegjës i Departamentit të Financës në UET (2010-2015), Zv.Rektor për Procesin Akademik në UET (2016-2017), Dekan i Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit në UET (2019-2023), Administrator i Kolegjit Universitar “LUARASI” (2017-2018), Drejtor i Përgjithshëm i “Bursa e Tiranës” (2002-2005), Sekretar i Përgjithshëm i Shoqatës Shqiptare të Bankave, AAB (2005-2009), Drejtor i Përgjithshëm Financiar (CFO) në Emporiki Bank (Credit Agricole Group) (2009-2010), anëtar i Bordit të Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore – MADA (2007-2009), anëtar i Këshillit Konsultativ të Biznesit (2007-2009), Kryetar i Komitetit të Auditit të Brendshëm të Sektorit Publik në Ministrinë e Financave (2014-2016), anëtar i Komitetit të Auditit të Brendshëm të INSIG (2015-2019). Prof. Dr. Meka ka qenë Kryeredaktor i revistës “BANKIERI”, botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave (AAB) (2011-2021), anëtar i bordit editorial të Revistës “ECONOMICUS” (2011-) dhe Kryeredaktor i saj (2021-2023), botim i Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit & Zhvillimit të UET, si dhe është aktualisht Kryetar i Këshillit të Administrimit të AK Invest (2017-) dhe anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bursa Shqiptare e Titujve - ALSE (2018-).

Prof. Dr. Elvin Meka ka marrë pjesë, si eksperti kryesor, në shumë programe Erasmus+ të Bashkimit Evropian, si dhe ka fituar projektin Jean Monnet Center of Excellence, 2023-2026 (Projekti: EUFutur – Enhancing EU Integration process literacy among university students in Western Balkans).